

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi kryetare, Ramiz Kuqi dhe Gani Avdiu, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit M.I., nga fshati ... Komuna e Podujevës, kundër të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPM SHCK), me bazë juridike anulimin e vendimit, të organit të paditur, duke vendosur, lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.328/15, të datës 10.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12.02.2019, merr këtë;

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pa bazuar, ankesa e paditësit M.I. nga fshati ... Komuna e Podujevës, e datës 05.02.2018, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.328/15, i datës 10.01.2018, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar, e refuzon kërkesëpadinë e paditësit M.I. nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të anulohet Vendimi KPM SHCK A/02/589/2014, i dt.19.01.2015, si e pa bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, për shkak të; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe materiale dhe shkeljes së procedurës kontestimore, me pretendimin se aktgjykimi A.nr. 328/15 i cituar është në kundërshtim të plotë me vetveten, procedurat, aktet nënligjore dhe ligjit për shërbimin civil si dhe ligjit për procedurën administrative të ankimimit. Me arsyetimin se “nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit” në padi janë dy ankesa; mos zbatimi i vendimit nr.09/2014 të datës 21.02.2014, me nr.prot. 02/286 të Sekretarit të Përgjithshëm caktohet ushtrues i divizionit Qendror Harmonizues, ku nga mos zbatimi i këtij vendimi nga Ministria e Financave, ankuesi është dëmtuar në pagën mujore përafërsisht 114 euro, ky dallim është pasi që Qeveria me vendimin numër 01/176 të datës 10.03.2014, ka rritur pagat për 25%. Gjykata në fjalë nuk ka marrë për bazë vlerën e koeficientit pas rritjes së pagave sipas vendimit të Qeverisë. Prandaj kjo gjendje ka vazhduar nga 20.02.2014 deri me 26.06.2017 për 41 muaj radhazi ka punuar dhe nuk i janë paguar shtesat sipas vendimit nr.09/2014 të datës 21.02.2014 me nr. prot.02/286 të Sekretarit të Përgjithshëm kur caktohet ushtrues detyre për koeficientin 9, kjo vërtetohet me listën e pagave. Ndërsa nga mos zbatimi i nenit 3 par.2 të Ligjit nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil është qartë e përcaktuar se: “Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruar të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë”, për mos zbatimin e këtij ligji është dëmtuar në pagën mujore përafërsisht 827 euro ky dallim është pasi që MF nuk ka zbatuar ligjin për nivelim të pagës. Po ashtu, paditësi ka pretenduar se ankuesi ka bërë përpjekje që të realizoj të drejtën e tij

të mohuar përmes procedurave të brendshme administrative në pajtim me nenin 50 par.2 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke bërë komunikim zyrtar elektronik me kërkesa verbale e të shkruara që kontesti të zgjidhet konform nenit 6 të Rregullores nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave dhe kur nuk është zgjidhur kontesti ka qenë i detyruar që të paraqes ankesën konform me nenin 50 parag.1 të të njëjtës rregullore. Përderisa nuk kanë përfunduar procedurat e shterjes së mjeteve të brendshme juridike nuk ka pasur të drejtë ligjore të ankimit. Gjykatës i ka propozuar që të mbaj shyrtrim kryesor në këtë çështje ashtu që pasi të administron të gjitha provat, ta aprovoj ankesën e M.I. nga fshati ... Komuna e Podujevës, me sa vijon; Anulohen vendimet e të paditurave si të kundërligjshme dhe atë: vendimi A 02/589/2014 të datës 19.01.2015, si dhe vendimi nr.02a/2017 të datës 28.10.2014 i Ministrisë së Financave, ndërsa detyrohet e paditura që të kompensojë pagat e paditësit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kërcënim përmbarimi.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) dhe neni 194 i LPK-së (ligj i zbatueshëm si në vështrim të nenit 63 të LKA-së), gjen se;

#### **Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e organit të paditur KPMSHC A/02/589/2014, të dt.19.01.2015, është hedhë poshtë si e pa lejuar ankesa me numër A/02/589/2014, e datës 19.11.2014, e parashtruar nga ankuesi M.I. nga fshati ..., Komuna e Podujevës.

I pa kënaqur me këtë vendim paditësi, ka ushtruar padi në gjykatë me datë 20.02.2015, kundër të paditurit Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Kosovës, duke pretenduar se vendimi i të paditurit është jo ligjor. Gjykata e shkallës së parë për këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor, me dt.10.01.2018, në prani të paditësit dhe përfaqësuesit të tij e në mungesë të palës së paditur dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se: organi administrativ drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, kur pasi ka administruar provat ka vlerësuar se duhet të hedhet poshtë ankesa e ankuesit si e pa lejuar, me arsyetimin se kërkesa e ankuesit tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave si komision i organit të shkallës së parë është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor të paraparë për ankesë. Kjo gjykatë pas administrimit të provave ka konstatuar se meqë afati për ankim rrjedhë nga data kur ankuesi merr njoftimin se i janë cenuar të drejtat e tij e që për ankuesin ky fakt është paga e parë e dalur në xhironlogarinë e tij me dt.01.04.2014, pasi që ka marr vendimin për caktimin UD për pozitën me dt. 20.02.2014, e ku ankuesi tek punëdhënësi i tij ankesën e ka paraqitur me dt.28.10.2014, nga kjo gjendje faktike e vërtetuar nënkuptohet se kërkesa e tij për kompensimin e mjeteve për ndryshimin e koeficientit për pozitën e caktuar të punëdhënësi është paraqitur jashtë çdo afati ligjor dhe në kundërshtim me Rregulloren nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, përkatësisht me nenin 8 par.2 të saj.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje

qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA). Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës iu ka referuar Ligjit për Procedurën Administrative përkatësisht nenit 8 paragrafit 2 të Rregullores nr.05/2011, për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave. Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të procedurës kontestimore, ky pretendim nuk qëndron me që gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave.

Ndërsa sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike gjithashtu kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit në padi janë të pabazuara, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Sepse paditësi me asnjë provë nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, se ankesa nuk rezulton nga faktet e vërtetuara dhe provat e vlerësuara, andaj thëniet e ankesës ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Lidhur me propozimin e palës paditëse që Gjykata e Apelit të hap shqyrtim gjyqësor për të vendosur lidhur me pretendimet e tij, kolegji të njëjtën e refuzoi si të pa bazuar, sepse pas shqyrtimit të shkresave të lëndës kolegji, erdhi në përfundim se nuk ekziston asnjëri nga kushtet e parapara me nenin 190 pika 2, 3 dhe 4 të LPK-së, i cili përcakton se: *“190.2 Gjykata e shkallës së dytë e cakton shqyrtimin e çështjes kur vlerëson se për konstatimin e gjendjes faktike, saktësisht dhe plotësisht, duhet vërtetuar fakte të reja dhe marrë prova të reja nën kushtet e nenit 180 paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji. 190.3 Gjykata e shkallës së dytë do ta caktojë shqyrtimin e drejtpërdrejt të çështjes edhe po që se aktgjykimi i shkallës së parë është anuluar dy herë dhe kur në seancën e kolegjit vlerëson se aktgjykimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht apo në mënyrë jo të plotë. 190.4 Gjykata e shkallës së dytë mund ta caktojë shqyrtimin e çështjes edhe kur vlerëson se me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet përsëri të merren të gjitha ose disa nga provat e administruara në gjykatën e shkallës së parë”*. Andaj duke iu referuar dispozitave ligjore të cekura më lartë gjykata e Apelit vendosi që shqyrtimin e kësaj ankese ta bëjë në seancën e kolegjit, pa hapur fare shqyrtim kryesor, sepse vlerësoi se ka fakte dhe prova të mjaftueshme që edhe pa hapjen e shqyrtimit gjyqësor të vendos drejt lidhur me këtë çështje administrative.

Sa i përket pretendimeve tjera ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktgjykimit të atakuar duke pretenduar në shkeljet e theksuara si në ankesë, Gjykata e Apelit vlerëson se janë të pabazuara sepse, nga shkresat e lëndës vërtetohet se me vendimin nr.09/2014 të Ministrisë së Financave të datës 20.02.2014 Paditësi është caktuar Ushtrues Detyre në NJQH/MFK si udhëheqës i Divizionit Qendror Harmonizues për Menaxhimin Financiar dhe Kontroll në Departamentin Qendror Harmonizues. Ku për këtë pozitë është paraparë koeficienti 9, niveli i pagës 418.89 euro. Ndërsa paditësi ka parashtruar kërkesë në Ministrinë e Financave me datë 28.10.2014, me kërkesë që Ministria ta trajtoj me pagë të njëjtë me udhëheqësin e divizionit tjetër në këtë departament. Paditësit ka filluar ti rrjedh afati nga momenti kur i ka dal paga në xhirrollogarinë e tij bankare, përkatësisht nga data 01.04.2014, ndërsa i njëjti kërkesën e ka parashtruar me dt.28.10.2014 pra jashtë afatit të paraparë me ligj ku neni 8 par.2 i Rregullores nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave ku përcaktohet se: *“Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”*. Prandaj, nuk kemi të bëjmë as me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ, siç e parasheh neni 194 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), për të cilat shkelje kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet e paditësit, në ankesë dhe konstaton se të njëjtat janë të pa bazuara në prova, të pa ndikim për tu ndryshuar gjendja faktike dhe për tu vendosur çështja në mënyrë tjetër, nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë në procedurë gjyqësore dhe nga organi administrativ përfundimtar KPMSHCK, sepse nga të cekurat më lartë, si dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, vërtetohet se në këtë çështje juridike administrative të paditësit drejtë është vlerësuar ligjshmëria e aktit administrativ përfundimtar në procedurë administrative dhe nuk është cenuar ligji në dëm të tij.

Nga të lartë cekurat e si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 200 i Ligjit për procedurën kontestimore, i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**AA.nr.99/2018, me datë 12.02.2019**

**Kryetare e kolegjit,**  
**Delushe Halimi**